KOMUNIKATË PËR MEDIA

Taksat Mjedisore në Kosovë, 2019 - 2021

28.07.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon për herë të parë statistikat e Taksave Mjedisore, për vitet 2019-2021.

Rriten të ardhurat nga taksat mjedisore

Në vitin 2021, të ardhurat nga taksat mjedisore arritën në vlerën 330 974 696 milionë euro, krahasuar me vitin 2020 ka pasur rritje prej 21.3%.

Të ardhurat nga taksat mjedisore sipas llojeve (milion euro)

	2019	2020	2021
Taksat e Energjisë (Akciza)	251 141 783	236 828 087	289 318 140
Taksat e Transportit	35 572 192	34 906 825	39 828 802
Taksat e Ndotjes	1 158 160	1 111 687	1 827 754
Gjithsej	287 872 135	272 846 599	330 974 696

Në vitin 2021, të ardhurat nga taksat e energjisë-akciza, kanë pasur rritje për 22,2%, krahasuar me vitin 2020; të ardhuat nga taksat e ndotjes kanë pasur rritje për 64,4%, krahasuar me vitin 2020; dhe të ardhurat nga transporti kanë pasur rritje për 14,1%, krahasuar me vitin 2020.

Struktura e të ardhurat nga taksat mjedisore sipas llojeve

Sipas strukturës së të ardhurave nga gjithsej taksat mjedisore për vitin 2021, taksat e energjisë zënë pjesën më të madhe të të ardhurave me 289 318 140 mil.euro, ose 87,4%, pasuar nga taksat e transportit me 39 828 802 mil.euro, ose 12,0%, taksat e ndotjes me 1 827 754, ose 0,6%.

Struktura e të ardhurave sipas llojeve (%)



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Pjesëmarrja e taksave mjedisore në BPV

Në vitin 2021, përqindja e të ardhurave nga taksat mjedisore, e pjesëtuar me BPV ishte 4,16%.

Pjesëmarrja e taksave mjedisore në BPV

Viti	2019	2020	2021
Taksat	4,07	4,03	4,16

Për më shumë informata, lidhur me publikimin Taksat Mjedisore 2019 – 2021, vizitoni:
https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/bujqesi/mjedisi